



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTER

NR:

PROT. 1167

DATA

02/12/2022

KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 90 datë 24.11 2022

PËR

“MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT PËR “SUBVENCIONIN E INTERESIT TË KREDISË”, FINANCUAR NGA BUXHETI I SHTETIT PËR Z.LAERT BRAHO”

Në mbështetje të nenit 24 pika 2, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, pika 5 e nenit 15 të Ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, pikës 18 të VKM nr. 384 datë 12.06.2019, “Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas programit social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr. 453 datë 03.07. 2019, “Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së saj për familjet që përfitojnë banesa me kosto të ulët , me kredi të lehtësuara nga Shteti”, VKB nr. 5, datë 29.01.2021 “Për miratimin e ngritjes, përbërjes dhe funksionimit të Komisionit të Strehimit”, shkresës nr. 18627 prot, datë 17.10.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, “ Mbi projektin për subvencionimin e interesave të kredisë”, si dhe VKB nr .7, datë 29.01. 2021 “Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit”, “Subvencionin e interesave të kredisë” financuar nga Fondet e Buxhetit të Shtetit dhe Njësisë së Qeverisjes Vendore”, Këshilli i Bashkisë Gjirokastër, në mbledhjes e datës 24/11 /2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

VENDOSI.

- 1- Të miratojë shtyrjen e afatit të “Subvencionit të Kredisë”, për qytetarin z. Laert Braho.
- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtorja e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të tij.

KRYETAR I KËSHILLIT

Lavdi HASANI

